Për këto vepra penale, gjatë vitit 2018 janë hetuar gjithsej 65 procedime penale me 16 të pandehur dhe 8 të arrestuar.

Janë pushuar 18 procedime penale, për shkaqe të tjera, për veprat penale të parashikuara nga nenet 84,88, 89, 96, 99,108/a/1, të K.Penal. Janë pushuar hetimet për 1 person nën hetim të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i K.Penal, për shkak se

nga akti i ekspertimit mjekoligjorë kanë rezultuar dëmtime të lehta duke u kualifikuar vepra penale më pas plagosje e lehtë me dashje dhe i dëmtuari e ka tërhequr ankimin për këtë vepër penale.

Janë *pezulluar* hetimet për 3 procedime penale për mosnjohje të autorit për këto grup veprash penale :

për 2 procedime penale për veprën penale parashikuar nga neni 124/1 të K.Penal e 1 procedim penal për veprën penale parashikuar 124/b/1 të K.Penal.

Janë *transferuar për shkak të kompetencës tokësore dhe lëndore* 5 procedime penale me 7 persona nën hetim dhe 1 të arrestuar, përkatësisht për veprat penale 79/c, 89, 126130/a/1 të K.Penal.

Janë *dërguar për gjykim* 15 procedime penale me 16 të pandehur, ku 7 kanë qenë me masën e sigurimit arrest në burg.

Vlen të përmendim këtu, ndër të tjera, 2 procedime penale janë për veprën penale të “*Vrasjes me dashje*”, mbetur në tentativë, me 2 të pandehur të arrestuar, 1 procedim penal për veprën penale të “*Kanosjes*” me 1 të pandehur të arrestuar, 1 procedim penal për veprën penale të “*Plagosje e rëndë me dashje*”, me 1 të pandehur me 1 të arrestuar, 1 procedim penal për veprën penale të “*Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme*” me 1 të pandehur dhe 1 të arrestuar, dhe 6 procedime penale me 6 të pandehur, ndër ta, 6 të arrestuar, për veprën penale të “*Dhunës në familje*”, 2 procedime penale janë për veprën penale të “*Plagosjes së lehtë me dashje*” me 2 të pandehur , 1 procedim penal për veprën penale të “*Dhunimi i banesës*” me 1 të pandehur dhe 1 procedim penal për veprën penale të “*Shfrytëzim i prostitucionit në rrethan rënduese*” me 1 të pandehur dhe 1 të arrestuar.

Gjithsej për këto grup veprash penale, për vitin 2018 janë përfunduar 15 procedime penale. Për vitin 2018 kanë mbetur në hetim 6 procedime penale .

Në këndvështrim krahasues me vitin 2017 konstatohet se për këto grup veprash penale ka një rënje të numrit të këtyre veprave penale në përgjithësi, të krimit kundër jetës së personit, të dhunës në familje në veçanti.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË

Janë *mbartur* nga viti i kaluar 61 procedime penale. Gjatë vitit 2018 janë *regjistruar* 180 procedime penale. Kanë ardhur me shpallje moskompetence nga Prokuroritë e tjera 14 procedime penale.

Janë pushuar mungese fakti 29 procedime penale me 3 persona nën hetim, për mungesë provash 3 procedime penale me 1 person nën hetim

Janë *pushuar* për shkaqe të tjera 17 procedime penale me 6 persona nën hetim, ku njëri prej tyre ka qenë i arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a/1 i K.Penal, kjo për shkaqe të tjera, për shkak se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

Numrin më të madhe të pushimeve e zënë procedimit penal për veprën penale shkatërrimit të pronës me zjarr me 6 procedime, vjedhjes së pasurisë me 5 procedime, shpërdorimit të tokës me 5 procedime penale. Janë pushuar 5 procedime penal për veprën penale të trafikimit të mjeteve motorike, 4 procedime penale janë pushuar për veprën

penale të parashikuar nga neni 189/1 i K.penal, 4 procedime penale janë pushuar për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, 3 procedime penale janë pushuar për veprën penale të shkatërrimit të pronës, 3 procedime penale janë pushuar për veprën penale të parashikuar 174/1 i K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale të mashtrimit, 2 procedime penal për veprën penale të mashtrimit ne sigurime, etj,

Janë *pezulluar* për mosnjohje të autorit të veprës penale 102 procedime penale.

Numrit më të madh vazhdon ta zë vepra penale e vjedhjes (63 procedime penale).

Është vendosur shpallja e moskompetencës për 10 procedime penale me 3 persona nën hetim.

Nga këto vepra penale, *janë dërguar* për gjykim 58 procedime penale me 63 të pandehur, ndër ta, 10 me masë sigurimi arrest në burg. Vendin kryesor të procedimeve penale të dërguar për gjykim për këto grup veprash penale e zënë për veprën penale të vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike (17 procedime penale), për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm me (13 procedime penale) dhe vjedhjes së pasurisë me (8 procedime penale me 10 të pandehur, 4 të arrestuar), pastaj renditen për veprat penale në fushën e doganave (7 procedime penale 8 të pandehur e 1 të arrestuar), për veprën penale të vjedhjes (8 procedime penale, me 10 të pandehur, 4 të arrestuar), falsifikimit të vulave, stampave ose i formularëve me (3 procedime penale, me 3 të pandehur, 2 prej tyre të arrestuar), fallsifikimi i dokumentave me (3 procedime penale, me 3 të pandehur), fallsifikimi i leternjoftimeve, i pasaportave ose i vizave (2 procedime me 2 të pandehur, 1 të arrestuar), etj.

Gjatë këtij viti, për këto grup veprash penale janë përfunduar 219 procedime penale, kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 49 procedime penale.

Numrin më të madh të procedimeve e zënë vepra penale e vjedhjes ë energjisë elektrike ose impulseve telefonike, *vjedhjes së pasurisë* dhe ajo e ndërtimit të paligjshëm, pastaj për veprat penale në fushën e doganave, falsifikimit etj.

Ajo çfarë mund të theksohet karahasuar me vitin e kaluar është se kemi një rritje të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim në krahasim me ato të pezulluara dhe të pushuara, por, vazhdojmë të kemi problematikë me hetimin e veprës penale të vjedhjes, ku nga 62 procedime penale të regjistruar për këtë vit, 63 prej tyre janë pezulluar për mosnjohje të autorit të veprës penale, vetëm 7 procedime penale janë dërguar për gjykim.

Problematikë në hetimin e kësaj vepre penale ka qenë mungesa e mbledhjes së të dhënave dhe marrja e informacioneve në rrugë të ndryshme nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore për autorët e mundshëm të veprës penale. Kjo, ka ndodhur edhe tek ato ngjarje ku janë fiksuar dhe marrë gjurmë daktiloskopike të vlefshme për t'u krahasuar me persona të dyshuar. Një konsistim i tillë qëndron edhe për procedimet penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitet e kaluara, të pezulluara më parë, të cilët janë pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale për këtë vepër penale.

Për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale janë pushuar 80 procedime penale.

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

Nga viti 2017 është *mbartur* një procedim penal.

Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 7 procedime penale me 1 të pandehur në gjendje të lirë për veprën penale të “Prerjes së paligjshme të pyjeve”.

Është pushuar 1 procedim penal për mungesë fakti, 4 proçedime janë pezulluar, 1 proçedim penal me 1 të pandehur është dërguar në gjyq, dhe 2 procedime janë në hetim.

VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT

Nga viti 2017 janë mbartur 64 procedime penale.

Gjatë vitit 2018 janë **regjistruar** 144 **procedime penale**, kanë ardhur me transferim 180 **procedime penale**.

Gjithsej ka patur në hetim për këto grup veprash penale 388 **procedime penale** me 62 persona nën hetim e 251 të pandehur, nga të cilët 41 persona të arrestuar.

Janë **pushuar** për mungesë fakti 63 procedime penale me 22 persona nën hetim, janë pushuar për 35 shkaqe të tjera me 13 persona nën hetim.

Janë **pezulluar** për mosnjohje të autorit 15 **procedime penale**. Numrin më të madh të procedimeve penale të pezulluara e zënë për veprën penale të përdorimit me keqdashje i thirrjeve telefonike” me (7 procedime penale), për veprën penale shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me (3 procedime penale) si dhe 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal, etj.

Është vendosur shpallja e moskompetencës për 17 **procedime penale**.

Janë **dërguar gjyqit** 191 **procedime penale me 239 të pandehur**, ku 39 prej tyre kanë qenë me masën e sigurimit arrest në burg.

Nga procedimet penale të dërguara për gjykim : 125 proçedime penale për veprën penale kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror me 131 të pandehur, 29 procedime penale për veprën penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt me 29 të pandehur, 7 prej tyre të arrestuar, 7 procedime penale për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugorë me 7 të pandehur, 2 prej tyre të arrestuar, 4 procedime penale për veprën penale të mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik, me 4 të pandehur, 3 procedime penale për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik me 34 të pandehur, 16 prej tyre të arrestuar, 2 procedime penale me 2 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 248 të K.Penal, 2 procedime penale me 2 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 235/1 i K.Penal, 2 procedime penale me 2 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 237 i K.Penal, 3 procedime penale me 5 të pandehur, nga të cilët 9 të arrestuar për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitja e narkotikëve, 2 procedim penale për veprën penale të “Kultivimi i bimëve narkotike“ me 3 të pandehur, nga të cilët 1 të arrestuar, 2 proçedime penale me 2 të pandehur , 1 të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal, 2 procedime penale, me 9 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i K.Penal, 1 procedim penal , me 1 të pandehur, 1 të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i K.Penal, 1 proçedim penal , me 1 të pandehur, 1 të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a/1 i K.Penal, 1 procedim penal, me 1 të pandehur , për veprat penale të parashikuara nga nenet 236/1, 274, 275, 278/5, 288/1 dhe 289/1 të K.Penal.

Gjatë vitit 2018 janë përfunduar gjithsej për këto grup veprash penale 321 procedime penale.

Kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 67 procedime penale.

Nga treguesit konstatohet se ka një rënje të veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit, të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike, kultivimit të bimëve narkotike, të vetëgjyqësisë, etj, por ka një rritje të veprave penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor.

VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Për këto grup veprash penale nuk ka patur të mbartura nga viti 2017.

Për vitin 2018 janë regjistruar 4 procedime penale.

VEPRAT PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA

Edhe për këtë grup veprash penale nuk ka patur të mbartura nga viti 2017.

Për vitin 2018 është regjistruar 1 procedim penal me 1 person nën hetim, i cili është pushuar .

TREGUESIT NË GJYKIM

Treguesit e përgjithshëm të çështjeve penale të gjykuara

Për vitin 2018 janë dërguar për gjykim 266 çështje penale me 319 të pandehur, nga të cilët 57 të arrestuar.

Gjatë vitit 2018 kanë mbetur në gjykim 65 çështje penale me 79 të pandehur, 16 me masën e sigurimit arrest në burg.

Gjithsej për vitin 2018 kanë qenë në gjykim 331 çështje penale me 398 të pandehur, ndër ta, 76 me masë sigurimi arrest në burg.

Për vitin 2018 janë gjykuar 206 çështje penale me 262 të pandehur dhe 49 të arrestuar. Nga këto, janë gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë 11 çështje penale, me gjykim të zakonshëm 4 çështje penale, me gjykim të shkurtuar 192 çështje penale.

Për vitin 2018 janë bërë 75 kërkesa për miratim të urdhërit penal , ku nga gjykata janë miratuar 73 urdhëra penal dhe janë refuzuar dy urdhëra penal.

Janë bërë 46 kërkesa për miratim marrëveshje dhe nga gjykata janë miratuar 42 marrëveshje dhe janë refuzuar 4 marrëveshje.

Jane bërë 147 kërkesa per dërgimin e çështjes në gjyq me 195 të pandehur, ku është miratuar kërkesa për dërgim në gjyq 94 procedime penale dhe për 5 procedime penale është vendosur kthimi i akteve, ndërsa 48 kërkesa janë ende në fazën e seancës paraprake.



Për vitin 2019 kanë mbetur në gjykim 125 *çështje penale me 136 të pandehur, ndër të cilët 27 të arrestuar.*

❖ **Llojet dhe masa e dënimit të kërkuara nga prokurorët:**

Për 124 të pandehur është kërkuar dënimi me gjobë, për 24 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 23 të pandehur dënimi me burgim mesatar, për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë për 82 të pandehur, 3 te pandehur pushim akuze, kjo për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

❖ **Vendimet e Gjykatës për llojet dhe masat e dënimit:**

Për 124 të pandehur është vendosur dënimi me gjobë, për 23 te pandehur dënimi me burgim në minimum, për 22 të pandehur me burgim mesatar, për 82 të pandehur është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, për 6 të pandehur është vendosur pafajësi. kjo për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, apeluar ne Prokurorine e Apelit Shkoder.

❖ **Të dhënat për vendimet e pafajësisë, ndryshimet e cilësimit juridik të veprës penale në gjykatë apo gjatë hetimeve paraprake si dhe kërkesat për pushim me persona të arrestuar:**

Pafajsitë: Për vitin 2018 nga gjykata është dhënë pafajsi në dy raste nga të cilat njëra është dhënë në çështjen penale me 6 te pandehur në ngarkim të shtetasit Hasan Halilaj etj për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal me 3 të pandehur të cilët fillimisht janë hetuar me masën e sigurimit parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, zëvendësuar më pas me masën e sigurimit të parashikuar nga neni 234 i K.Penal (procedimi penal është i

vitit 2015) ndërsa pafajsia tjetër është dhënë për çështjen penale në ngarkim të shtetasit Ermal Islamaj për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Këto dy çështje penale janë hetuar dhe përfaqësuar në gjykim nga Prokurorja Rita Gjati.

Ndryshimet e cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata: Gjkata ka vendosur ndryshimin e cilësimit juridik në tre raste; çështja penale në ngarkim të shtetasit Sokol Tërshalla nga neni 76/22 të K.Penal në nenin 82 të K.Penal; çështja penale në ngarkim të pandehurit Zek Asllanaj nga neni 76/22 në nenin 89 të K.Penal; çështja penale në ngarkim të shtetasve Kismet Matmuja dhe Jetlind Matmuja nga neni 283/2 i K.Penal në nenin 283/1 dhe 300 të K.Penal. si dhe çështja penale në ngarkim të shtetasit Ermal Islamaj nga neni 259 i K.Penal në atë të parashikuar nga neni 164/b i K.Penal.

Çështja penale në ngarkim të shtetasit Sokol Tërshalla janë përfaqësuar në gjykim nga prokurori Edmond Kariqi ndërsa dy çështjet e tjera janë hetuar edhe përfaqësuar në gjykim nga Prokurorja Alketa Nushi.

Pushimet e çështjes të kërkuara nga prokurori në gjykatë pasi janë dërguar për gjykim: Është kërkuar pushimi i çështjes nga prokurori në fazën e konkluzione përfundimtare në dy raste: Në çështjen penale në ngarkim të shtetasit Luan Tërshalla për veprën penale të parashikuar nga neni 76/22 të K.Penal, hetuar e gjykuar me masën e sigurimit personal arrest në burg. Kjo çështje është përfaqësuar nga prokurori Edmond Kariqi.

Si dhe çështjen penale në ngarkim të shtetasve Mirdash Hoxha, Majlinda Hyka dhe Gëzim Ulkperaj të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal të cilët fillimisht janë hetuar me masën e sigurimit parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, zëvendësuar më pas me masën e sigurimit të parashikuar nga neni 234 i K.Penal. Gjkata ka vendosur pafajsi. Kjo çështje është përfaqësuar nga prokurorja Rita Gjati.

Për të gjitha rastet kur gjykata ka vendosur pafajësi apo ndryshim të cilësimit juridik të veprës penale është ushtruar e drejta e ankimit. Vetëm në një rast Gjkata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë (çështja në ngarkim të shtetasit Sokol Tërshalla).

Për vitin 2018 nuk është kërkuar në asnjë rast pushimi i procedimit penal me persona të arrestuar si dhe nuk është dhënë asnjë pafajsi për procedimet penale të regjistruara dhe të hetuara në vitin 2018.

❖ **Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si gjinia, moshën, arsimin, punësimin etj.**


Për vitin 2018 janë dënuar 262 të pandehur nga këto 247 janë meshkuj dhe 15 të pandehura femra dhe 6 të pandehur shtetas të huaj.

Janë dënuar 193 persona me arsim 9-vjeçarë, 62 persona me arsim të mesëm dhe 7 persona me arsim të lartë.

Janë dënuar 7 persona me gjendje shoqërore nëpunës të nivelit të mesëm, 3 persona nëpunës të nivelit të ulët, 1 person nëpunës i thjeshtë, 38 persona në sektor privat dhe 212 persona të papunë.

Janë dënuar 82 persona me banim në qytet dhe 180 në njesitë administrative të Bashkisë Kukës e Has.

Janë dënuar 251 persona me gjendje gjyqësore të padënuar, 9 persona me gjendje gjyqësore përsëritës të veprave penale të ndryshme, dhe 2 persona përsëritës të të njëjtës vepër penale.



❖ Të dhënat për procedimet penale për të miturit në konflikt me ligjin:

Për vitin 2018 janë regjistruar 8 procedim , me 8 persona të mitur në konflikt me ligjin, për veprat penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror parashikuar nga neni 297 i K.Penal mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik parashikuar nga neni 242 i K.Penal dhe fallsifikimit të akteve të gjendjes civile parashikuar nga neni 191 i K.Penal.

Për 3 procedime penale me 3 persona nën hetim është vendosur shpallja e moskompetencës dhe kalimi i akteve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër (Seksionit të miturve), për 4 procedime penale, me 4 persona të mitur nën hetim është vendosur pushimi i procedimit penal për shkak se janë aplikuar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe 1 procedim penale me 1 të pandehur është dërguar në gjykim, ku është dënuar me dënim alternativ punë në interes publik.

Më poshtë po i trajtojmë më hollësisht treguesit e çështjeve penale në gjykim.

VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT

Nga viti 2017 kanë qenë *mbartur* në gjykim 4 çështje penale me 4 të pandehur, nga të cilët 2 të arrestuar.

Gjatë vitit 2018 janë *dërguar për gjykim* 15 çështje penale me 16 të pandehur, nga të cilët 7 persona të arrestuar.

Janë *gjykuar gjithsej* nga këto grup veprash penale 9 procedime penale me 9 të pandehur, 8 të arrestuar.

Për vitin 2019 kanë *mbetur në gjykim* 10 çështje penale me 11 të pandehur, 4 të arrestuar.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga Prokurorët:

Janë dhënë për 1 të pandehur dënim me gjobë (neni 89 i K.Penal), për 4 të pandehur dënim me burgim në minimum (neni 130/a/1 i K.Penal), për 2 të pandehur dënim me burgim mesatar (nenet 88 e 89 të K.Penal), për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum dhe për 1 të pandehur dënimi me burgim mesatar (neni 76-22 i K.Penal).

Gjykata ka vendosur në përputhje me kërkesën e prokurorit.

Dënimi me gjobë është kërkuar për 1 të pandehur, akuzuar për veprën penale të "Plagosjes së lehte", është kërkuar për 4 të pandehur të arrestuar për veprën penale të dhunës në familje dënim me burgim në minimum, është kërkuar për 2 të pandehur me të arrestuar dënim me burgim në minimum dhe burgim mesatar, për veprën penale të parashikuar nga neni (76-22 të K.Penal), është kërkuar për 2 të pandehur me të arrestuar dënim me burgim mesatar, për veprat penale (88 e 130/a/4 të K.Penal)

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË

Janë *mbartur* në gjykim për vitin 2018 gjithësej 21 çështje penale me 21 të pandehur nga të cilët 2 të arrestuar.

Për vitin 2018 janë *dërguar gjithsej* në gjykim 58 çështje penale me 61 të pandehur nga të cilët 10 të arrestuar.

Janë *gjykuar gjithsej* 52 çështje penale me 57 të pandehur, nga të cilët 9 të arrestuar.

Për vitin 2019 kanë *mbetur në gjykim* 25 çështje penale me 25 të pandehur me 3 të arrestuar.

Në konkluzionet përfundimtare nga Prokurorët janë kërkuar këto lloje dhe masa dënimi:

Për 5 të pandehur dënim me gjobë, për 5 të pandehur dënim me burgim në minimum, 6 të pandehur dënim mesatar, për 41 të pandehur pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Edhe për këtë grup veprash penale Gjykata e Shkallës së Parë Kukës ka vendosur në përputhje me kërkesën e Prokurorit.

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

Nga viti 2017 ka patur 3 çështje të mbartur në gjykim për këto grup veprash penale.

Gjatë vitit 2018 është regjistruar 1 procedim penal, me 1 të pandehur.

Për vitin 2019 kanë mbetur në gjykim 4 çështje penale me 4 të pandehur.

VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT

Nga viti 2017 kanë qenë të mbartura në gjykim 33 çështje penale me 44 të pandehur.

Gjatë vitit 2018 janë dërguar për gjykim për këto grup veprash penale 191 çështje penale me 239 të pandehur, me 38 të arrestuar.

Për vitin 2018 kanë qenë gjithësej në gjykim 224 çështje penale me 283 të pandehur.

Janë gjykuar gjithsej 142 çështje penale me 194 të pandehur.

Për vitin 2019 kanë mbetur në gjykim për këto grup veprash penale 72 çështje penale me 74 të pandehur.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga prokurorët këto lloje dhe masa dënimi:

Për 118 të pandehur dënim me gjobë, për 19 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 12 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 39 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë. Për 3 të pandehur është vendosur pushim çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 248 (6 të pandehur në gjendje të lirë).

Gjykata ka vendosur për 118 të pandehur dënim me gjobë, për 19 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 12 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 39 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Për 6 të pandehur është vendosur pafajësi për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Për rastet kur Gjykata ka vendosur pafajësisë, nga prokurori i çështjes është apeluar vendimi në Gjykatën e Apelit Shkodër

Dënimi me gjobë është vendosur për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror ,për veprën penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt.

VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Nga viti 2016 nuk është *mbartur* asnjë procedim penal.

Për vitin 2017 duke qenë edhe viti ku u mbajtën Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare janë regjistruar 5 procedime penale me 2 persona nën hetim. Janë pushuar 4 procedime penale me një persona nën hetim dhe për 1 procedim vazhdojnë hetimet.

TREGUESIT E MASAVE TË SIGURIMIT

Gjatë vitit 2018: Janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore 72 të pandehur. Janë ndaluar me iniciativë të policisë gjyqësore 2 të pandehur. Janë ndaluar me urdhër të Prokurorit 35 të pandehur. Është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest ne burg” në mungesë për 4 të pandehur.

Rezulton se gjykata ka vleftësuar si të ligjshme arrestet në flagrancë si dhe urdhërat e ndalimit përveç se ka konsideruar të paligjshëm një arrestim në flagrancë për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal si dhe një urdhër ndalimi të prokurorit për veprën penale të parashikuar nga neni 237 i K.Penal.

Është kërkuar masa e sigurimit arrest në burg për 37 të persona, për 3 të pandehur masa e sigurimit arrest në burg në mungesë, arrest në burg me afat për 3 të pandehur, për 9 të pandehur arrest në shtëpi, për 39 të pandehur detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore. Ndërsa masë sigurimi pasuror për vitin 2018 nuk kemi pasë asnjë.

Gjykata ka vendosur për 35 të pandehur masën e sigurimit arrest në burg, për 3 të pandehur arrest në burg në mungesë, për 11 të pandehur arrest në shtëpi, për 3 të pandehur arrest në burg me afat, për 39 të pandehur detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore.

Nga treguesit statistikor konstatojmë se janë mbështetur nga gjykata kërkesat e prokurorit për caktimin e masës shtrënguese.

Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar në ato raste, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të autorit, shtrirjen e veprës penale në vend. Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar për veprat penale kundër jetës së personit, tek vepra penale e vrasjes mbetur në tentativë, plagosjes së rëndë me dashje, tek vepra penale e dhunës në familje, tek veprat penale kundër pasurisë dhe ekonomisë, siç kanë qenë vjedhja, , për krimet në fushën e doganave, si vepra penale e kontrabandës, si dhe tek veprat penale kundër autoritetit të shtetit, si kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik, tek veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, tek veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, si prodhimi dhe shitja e narkotikëve, prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, kur drejtuesi i mjetit ka qenë recidivist në rastet kur ka qenë i pa pajisur me leje drejtimi apo kur drejtuesi i mjetit ka qenë në gjendje të dehur etj.

TREGUESIT E ZGJATJES SË AFATEVE TË HETIMEVE PARAPRAKE

Afatet e hetimit janë zgjatur si më poshtë vijojnë:

- ❖ deri në 3 muaj për 6 procedime penale me 6 të pandehur, 1 prej tyre ka qenë i arrestuar.
- ❖ mbi 3 muaj deri në 6 muaj janë zgjatur afatet për 3 procedime penal me 3 të pandehur.
- ❖ mbi 6-9 muaj janë zgjatur hetimet për 3 procedime penale me 3 të pandehur.
- ❖ mbi 9 muaj janë zgjatur hetimet vetëm për një procedim penal me 1 të pandehur.

Siç shihet nga treguesit statistikor ka patur angazhim për të përfunduar hetimet paraprake në një kohë sa më shpejtë të jetë e mundur, duke i kushtuar rëndësi zgjidhjes së duhur të procedimeve penale brenda afatit ligjor, duke garantuar dhe respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, duke garantuar të drejtat procedurale të subjekteve të procedimit penal si dhe dhënien e drejtësisë në kohë.

TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME JASHTË

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur në gjykatë 27 (njëzet e shtatë) **kërkesa për ekstradim për Jashtë Shtetit** të personave të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të kërkuar nga Autoritetet e Shteteve të Tjera.

Gjykata ka vendosur lejimin e ekstradimit për 21 persona, për 5 ekstradime jemi në pritje të vendimeve të formës së prerë nga gjykatat, pasi janë ankuar subjektet dhe për një ekstradim është vendosur papranueshmëria e kërkesës për miratim ekstradimi pasi i arrestuari është larguar nga vendi i qëndrimit

Janë ekzekutuar 32 **letërporosi nga jashtë shtetit**, kryesisht nga autoritetet e drejtësisë kosovare, që kanë patur të bëjnë me njoftimin e dëshmitarëve apo të pandehurit, pyetjen e dëshmitarëve, etj. Janë dërguar për Jashtë shtetit 19 letërporosi për marrjen e provave.

Është bërë **njohja e vendimeve penale të huaja** (autoriteti gjyqësor i Kosovës) për 1 të dënuar, shtetas shqiptar..

Ka **ardhur me transferim nga jashtë nga Kosova**, 1 procedim penal , për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i K.Penal , i cili është pezulluar për mos zbulim autori.

Janë **transferuar për jashtë në shtetin e Kosovës**, 3 procedime penale, përkatësisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 180, 297 të K.Penal.

Janë transferuar persona të dënuar nga jashtë 21 shtetas të huaj.

Janë shpallur në kërkim ndërkombëtar për vitin 2018 , 5 shtetas, ku 4 janë me vendim të formës së prerë, ndërsa 1 me masë sigurimi “arrest në burg” në mungesë.

Janë hequr nga kërkimi ndërkombëtar 3 të dënuar, ku për 2 persona është parashikuar dënimi, ndërsa për 1 person është kapur dhe po kryen dënimin.

TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Nga viti 2017 kanë qenë të mbartur vendime të paekzekutuara për 30 të dënuar me burgim, për 110 të dënuar me gjobë dhe 111 të dënuar me kusht.

Gjatë vitit 2018 janë nxjerrë nga Prokuroria urdhërat e ekzekutimit të vendimeve penale për 94 të dënuar me burgim, për 165 të dënuar me gjobë, për 229 të dënuar me kusht, 3 të dënuar me kusht duke aplikuar nenin 59/a të K.Penal, dhe për 9 të dënuar duke aplikuar nenin 63 të K.Penal (kryesisht të dënuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 190/1 të K. Penal).

Gjatë vitit 2018 rezulton të jenë ekzekutuar tërësisht vendimet penale për 83 të dënuar me burgim, 2 të dënuar me gjobë, dhe për 150 të dënuar me dënime alternative.

Për dy të dënuar me dënime alternative është bërë kërkesë në gjykatë për revokim të aplikimit të nenit 59 të K.Penal ku një kërkesë është pranuar nga ana e gjykatës kurse kërkesa tjetër është ende në fazën e gjykimit.

Nuk janë ekzekutuar 2 kërkesa caktim mase sigurimi “arrest në burg” në mungesë.

TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT

Gjatë vitit 2018, nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës është përballuar një ngarkesë e konsiderueshme si në hetimin e procedimeve penale ashtu edhe në përfaqësime në gjykatë duke patur parasysh se me ndryshimet e ligjit procedural penal në vitin 2017 tashmë përfaqësohen në gjykim edhe kërkesat për pushimin e procedimeve penale të regjistruara për krime.

Më konkretisht po japim ngarkesën e punës për secilin prokuror si dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

❖ **Prokurore Alketa Nushi:**

Me funksionin e Drejtueses së Prokurorisë gjatë periudhës 09 Janar 2018 e në vazhdim, ka hetuar gjithsej 127 procedime penale, (29 procedime penale të mbartura nga vitit 2017 dhe 98 procedime penale të vitit 2018).

Janë dërguar për gjykim 31 procedime penale, janë pezulluar 21 procedime penale, janë pushuar 36 procedime penale nga të cilat (21 me vendim për pushim dhe 15 procedime penale me kërkesë për pushim). Është vendosur shpallja e moskompetencës për 5 procedime penale, kanë mbetur në hetim 34 procedime penale. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 27 kallëzime penale, kanë mbetur në hetim 34 procedime penale.

Nga Prokurore Alketa Nushi është përfaqësuar akuza në gjykatë për 34 çështje penale me 34 të pandehur, (7 të arrestuar, 8 të pandehur me detyrim për paraqitje dhe 19 të pandehur në gjendje të lirë). Janë gjykuar me gjykim të shkurtuar 33 procedime penale dhe 1 procedim penal me gjykim të zakonshëm.

Nga Prokurorja janë dhënë masa dënimi për 8 të pandehur dënime me burgim, 16 të pandehur denim me burg (vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim), për 9 të pandehur dënim me gjobë dhe për 1 të pandehur ka kërkuar pushimin e çështjes.

Nga ana e kësaj prokurore është ushtruar apelim për vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës në 3 raste. Dy për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe një ndaj vendimit të gjykatës për mos pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal. Vendimet e ankimuara janë lenë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër.

❖ Prokurore **Fahrije Vata:**

Nga muaji Shtator 2018, kur është rikthyer në punë, ka hetuar gjithsej 136 procedime penale, janë dërguar për gjykim 34 procedime penale, janë pezulluar 11 procedime penale, janë pushuar 26 procedime penale, janë transferuar 8 procedime penale. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 25 kallëzime penale.

Nga ana e prokurores Fahrije Vata është përfaqësuar akuza në gjykatë për 15 çështje penale me 15 të pandehur (13 në gjendje të lirë dhe 2 me detyrim për paraqitje).

Nga Prokurorja janë dhënë 11 dënime me gjobë, 1 dënim me burg, dhe 3 dënime alternative (burg me kusht).

Nga ana e kësaj prokurore është ushtruar apelim për vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës në 3 rast persa u perket masave të sigurimit kur gjykata ka vendosur masa më të bura sigurime se ato të kërkuesit nga ana e Prokurores. Vendimet e ankimuara janë lenë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër.

❖ Prokurore **Rita Gjati:**

Ka hetuar gjithsej 273 procedime penale, (33 procedime penale të mbartuara nga vitit 2017 dhe 240 procedime penale të vitit 2018).

Janë dërguar për gjykim 109 procedime penale, janë pezulluar 47 procedime penale, janë pushuar 73 procedime penale nga të cilat (61 me vendim për pushim dhe 12 procedime penale me kërkesë për pushim). Janë transferuar 7 procedime penale, kanë mbetur në hetim 37 procedime penale. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 78 kallëzime penale.

Nga Prokurore Rita Gjati është përfaqësuar akuza në gjykatë për 60 çështje penale me 66 të pandehur (5 të arrestuar, 1 të pandehur me arrest në shtëpi, 7 me detyrim për paraqitje dhe 53 të pandehur në gjendje të lirë).

Janë gjykuar me gjykim të shkurtuar 52 procedime penale dhe 5 procedime penal me gjykim të zakonshëm. Nga Prokuroreja janë dhënë masa dënimi me burgim për 9 të pandehur, për 20 të pandehur denim me burg (vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim), për 29 të pandehur dënim me gjobë dhe për 3 të pandehur ka kërkuar pushim e çështjes.

Janë studiuar 30 procedime penale të viteve të kaluara dhe më pas është vendosur pushimi i tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Është përfaqësuar akuza në gjykatë për 30 çështje penale.

Nga ana e kësaj prokurore është ushtruar apelim për vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës në 2 raste. Një për vendimin e gjykatës i cili ka dhënë pafajsi për 3

të pandehur dhe një ndaj vendimit për caktimin e një mase sigurimi me të butë nga ajo e Prokurorit. Vendimi i gjykatës për pafajësi është lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër (vendimi është dhënë në vitin 2019). Ndërsa vendimin e masës së sigurimit është shpallur moskompetenca dhe gjykata kompetence ka dhënë masën e sigurimit të parahsikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale ndërkohë që Gjykata e Shkallës së Parë Kukës kishte caktuar masën e sigurimit të parahsikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

❖ **Prokurori Edmond Kariqi:**

Ka hetuar gjithsej 185 procedime penale (76 të mbartura nga viti 2017 dhe 109 procedime penale për vitin 2018), janë dërguar për gjykim 77 procedime penale, janë pezulluar 44 procedime penale, janë pushuar 48 procedime penale. Janë transferuar 9 procedime penale. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 54 kallëzime penale (3 kallëzime të vitit 2017). Nga ana e prokurorit Edmond Kariqi është përfaqësuar akuza në gjykatë për 84 çështje penale.

Janë studiuar dhe më pas është vendosur pushimi për 30 procedime penale të regjistruara në vitet e kaluara, pushimi i tyre është bërë për efekt parashkrimi të ndjekjes penale.

Nga ana e prokurorit është ushtruar ankim kundërshtues për një të pandehur me masë sigurie “arrest në burg”, i akuzuar për veprën penale të parahsikuar nga neni 88/1 i K.Penal, nga prokurori është kërkuar dënim me 3 vjet burgim, ndërsa nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës është dhënë vendimi me 2 vjet burgim. Gjykata e Apelit Shkodër ka lënë në fuqi Gjykata e Shkallës së Parë Kukës me ndryshimin pasi ka aplikuar dënimin alternativ të parahsikuar nga neni 59 i K.Penal.

Gjithashtu është bërë ankim kundër vendimit të Gjykatës së shkallës së Parë Kukës për një të pandehur me masë sigurimi “Arrest në burg”, i akuzuar për veprën penale të parahsikuar nga neni 76-22 i K.Penal, ku nga prokurori është kërkuar 13 vjet burgim, ndërsa nga gjykata është vendosur dënim me 5 vjet burgim. Gjykata e Apelit Shkodër ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Kukës duke e dënuar me 9 vjet burgim.

Ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës ku është pranuar zëvendësimi i masës së sigurimit nga ajo e parahsikuar nga neni 238 i K.Penal në atë të parahsikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër.


Prokurori ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës me anë të së cilit është vendosur aplikimi i nenit 59 të K.Penal për një të pandehur për veprën penale të parahsikuar nga neni 278\1 i K.Penal. Por edhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Nga ana e Prokurorit është ushtruar ankim ndaj vendimeve të gjykatës për prishje vendimit të mosfillimit të procedimit penal në 3 (tre) raste si ndaj vendimit të gjykatës për mospranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal në 1 (një) rast por këto vendime janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër.

❖ **Prokurori Sabri Kastrati:**

I caktuar përkohësisht në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës nga data 18.09.2017 – 19.01.2018 ka mbartur gjithsej nga vitit 2017 8 procedime penale, është pezulluar 1 procedim penal, janë pushuar 6 procedime penale, është transferuar 1 procedim penal. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 5 kallëzime penale (3 kallëzime të mbartura të vitit 2017 dhe 2 kallëzime të vitit 2018).

NGARKESA E PROKURORËVE



TREGUESIT E PUNËS PËR OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE

Në mënyrë të përmbledhur, paraqesim ngarkesën e punës për oficerët e policisë gjyqësore.


Oficeri i Policisë Gjyqësore **Vladimir Shehu** ka patur gjithsej në hetim 122, ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 14 procedime penale, për pushimin e hetimeve 19 procedime penale, për pezullimin e hetimeve 8 procedime dhe për gjykim 56 procedime penale. Ka mbartur për vitin në vazhdim 35 procedime penale. Nuk ka patur pavlefshmëri aktesh si dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimit kanë qenë në përputhje me vendimin e marrë nga prokurori. Nga ana e këtij oficeri janë ekzekutuar letëporosi të ardhura nga autoritetet e huaja në 16 raste.

Oficeri i Policisë Gjyqësore **Bashkim Malaj**, i cili me datë 22.11.2017 është emëruar si OPGJ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukë, ka patur gjithsej në hetim

31 procedime penale. Nga këto, ka sugjeruar për gjykim 13 procedime penale, për 2 procedime penale transferimin e tyre, për 6 procedime penale pushimin. Gjatë hetimit nuk ka patuar deklarime të pavlefshmërisë së akteve procedurale. Sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimit kanë qenë në unison me vendimmarrjen e prokurorit. Në 3 raste është bërë ekzekutimi i letërporosive të ardhura nga autoritetet e huaja

Oficeri i Policisë Gjyqësore, Seksioni i Policisë së Shtetit, **Bledar Xhoxha**, ka patur gjithsej në hetim 81, ka referuar për pezullimin e hetimeve 8 procedime penale, për pushim 8 procedime penale, për gjykim 47 procedime penale. Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të ndonjë akti dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit. Në 13 raste është bërë ekzekutimi i letërporosive të ardhura nga autoritetet e huaja.

Ngarkesa punës e Oficerëve të Policisë Gjyqësore



TË DHËNA MBI PJESËMARRJEN E PROKURORËVE NË
SEKSIONET TRAJNUESE PËR VITIN 2018

Prokurore Alketa Nushi:

1.	<u>19 janar 2018</u>	<u>SHM</u>	<p>Procesverbali i seancës gjyqësore në një procedim penal.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Transkriptimi; • Pavlefshmëritë e akteve. Analizë e dispozitave procedurale penale me fokus në nenet 115-117; 122-130 të Kodit të Procedurës Penale)
2.	<u>12 shkurt 2018</u>	<u>ShM / Observatori për të drejtat e fëmijëve</u>	Martestat nën moshë dhe roli i gjykatës në lejimin e këtyre martesave për shkaqe me rëndësi (pjesëmarrës gjyqtarë të GjRrGj Kukës)
3.	<u>30 mars 2018</u>	<u>KiE</u>	Liria e shprehjes në fokusin e miradministrimit të drejtësisë dhe kufijtë e ushtrimit të saj për profesionistët e drejtësisë (gjyqtarët, prokurorët, avokatët). Ankimi ndaj vendimeve të autoriteteve rregullatore të çështjeve që lidhen me të.
4.	<u>5-6 nëntor 2018</u>	<u>SHM</u>	Ankimi kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës, në rastin e kundërvajtjeve penale. Roli i gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe i seancës paraprake dhe problemet e praktikës gjyqësore.
5.	<u>3-4 dhjetor 2018</u>	<u>EURALIUS /SHM</u>	<p>Mbi disa amendime të Kodit të Procedurës Penale – “gjyqtari i seancës paraprake”.</p> <p>Roli i gjyqtarit të seancës paraprake, risitë dhe ecuria e praktikës gjyqësore.</p> <p>Seanca paraprake, si një nga risitë e sjella në Kodit e Procedurës Penale, me ligjin nr. 35/2017, në Kodin e Procedurës Penale. Veçoritë e seancës paraprake dhe të drejtat e palëve. Vendimi për plotësimin e hetimeve. Ndryshimi i akuzës në seancën paraprake. Paraqitja e kërkesës për gjykim të shkurtuar në seancën paraprake dhe roli që ka gjyqtari i seancës paraprake në shqyrtimin e saj. Llojet e vendimeve që merr gjyqtari në përfundim të seancës paraprake. Elementet e vendimit të seancës paraprake dhe fashikulli i gjykimit.</p>
6.	<u>7 dhjetor 2018</u>	<u>OSBE</u>	Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.

Prokuror Edmond Karriqi:

7.	<u>29-30 janar 2018</u>	<u>SHM</u>	<p>Padia civile në procesin penal.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Risitë e Kodit të Procedurës Penale lidhur me padinë civile në procesin penal; • Problematika e praktikës gjyqësore lidhur me padinë civile në procesin penal
8.	<u>12 shkurt 2018</u>	<u>ShM/ Observatori për të drejtat e fëmijëve</u>	Martestat nën moshë dhe roli i gjykatës në lejimin e këtyre martesave 'për shkaqe me rëndësi (pjesëmarrës gjyqtarë të GjRrGj Kukës)
9.	<u>14-15 shkurt 2018</u>	<u>SHM</u>	<p>Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ekstradimi; • Arresti i përkohshëm; • Njohja e vendimit penal të huaj për të gjykuarin në mungesë "in absentia" nga Autoriteti Gjyqësor i Huaj.
10.	<u>26-27 prill 2018</u>	<u>SHM</u>	Veprat penale në kushtet e tronditjes psikike. Vështrim krahasues me mbrojtjen e nevojshme dhe të drejtën ndërkombëtare penale.
11.	<u>30-31 maj 2018</u>	<u>Projekti i Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik</u>	<p>Krimi kibernetik.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Evidentimi i krimit kibernetik; • Procedimi Penal në rastet e krimit kibernetik: dëshmitë elektronike; • Të ardhurat nga krimi online; • Përdorimi i internetit për qëllime terroriste.
12.	<u>18-19 qershor 2018</u>	<u>Projekti i Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik</u>	<p>Krimi kibernetik.</p> <p>Evidentimi i krimit kibernetik;</p> <p>Procedimi Penal në rastet e krimit kibernetik: dëshmitë elektronike;</p> <p>Të ardhurat nga krimi online;</p> <p>Përdorimi i internetit për qëllime terroriste.</p>
13.	<u>12-13 nëntor 2018</u>	<u>SHM</u>	Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve.

Prokurore Rita Gjati:

14.	<u>28 shkurt 2018</u>	<u>KiE</u>	Parimet në dhënien e kompensimit në rastet e cenimit të lirisë së shprehjes
15.	<u>12-13 mars 2018.</u>	<u>SHM</u>	Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmerite e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjatë kesaj seance. Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake; Dita e dytë Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbësore të saj- detyrueshmëria dhe pakthyeshmëria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.
16.	27-28 qershor 2018 Prezent ditën e parë dhe sesionin e parë të ditës së dytë	<u>SHM</u>	Grupi i strukturuar kriminal, si formë e veçantë bashkëpunimi. • Dallimi mes grupit të strukturuar kriminal me bashkëpunimin e thjeshtë dhe organizatën kriminale. Problemet e praktikës gjyqësore; • Kufijtë e shtrirjes së përgjegjësisë penale individuale. Problematikat pas daljes së Vendimit Unifikues nr. 4, datë 15.04.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
17.	9 nëntor 2018 Prezent sesionin e parë	<u>KiE / JUFRE X</u>	E drejta e marrjes së informacionit – si po zbatohet ligji në praktikë?
18.	19-20 dhjetor 2018 Prezent ditën e parë dhe sesionin e parë të ditës së dytë	<u>SHM / IRZ</u>	Ligji i zbatueshëm për detyrimet jashtë-kontraktore. • Rregullorja Rome II e BE-së dhe ballafaqimi me të drejtën tonë materiale përkatëse; • Interpretimi me qëllim zbatimin korrekt të legjislacionit shqiptar të së drejtës ndërkombëtare private; • Ballafaqimi i Rregullores me legjislacionin e brendshëm.

ADMINISTRIMI I PROKURORISË

Në mbarëvajtjen e punës së veprimtarisë ne Prokurorinë Kukës, një rol të rëndësishëm kryen edhe administrata e prokurorisë. Rezulton së gjatë vitit 2018 është punuar në përmirësimin e punës së mbajtjes së regjistrave dhe raportimeve periodike të statistikave të prokurorisë. Gjithashtu është punuar për vënien në zbatim të sistemit CAMS.

Në lidhje me administrimin e prokurorisë gjatë vitit 2018 mund të themi se ka patur një administrim të drejtë për sa i përket zbatimit të buxhetit dhe kapaciteteve infrastrukturore të saj. Fondet e akodruara nga Prokuroria e Përgjithshme janë menaxhuar në mënyrë efikase dhe realizimi i tyre ka qenë në masën 99.9 %.

Nuk ka patur probleme me sigurinë e brendshme për mbarëvajtjen e punës. Po ashtu, janë krijuar marrëdhënie të besueshme me mediat dhe publikun duke dhënë informacion rreth përhapjes dhe goditjes së kriminalitetit për grup veprat penale që janë në rritje në vendin ku ushtron kompetencën territoriale kjo prokurori. Menaxhimi i brendshëm i Prokurorisë ka qenë sa më efikas, ka patur rregullsi në mbajtjen e regjistrave sipas praktikës së normuar të kësaj prokurorie. Po ashtu, ka patur korrektësi në ndjekjen e disiplinës dhe etikës në punë nga punonjësit..

Si përfundim, prioritet për vitin 2019 mbetet përfundimi në kohë të shpejtë i procedimeve penale të mbartura, rritja e shkallës së efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale nëpërmjet hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e doganave, të korrupsionit dhe krimit të organizuar, në fushën e lëndëve narkotike, në fushën e krimit ekonomik, rritja e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit si dhe organet e tjera ligjzbatuese në vend .

DREJTUESI I PROKURORISË

ALKETA NUSHI